



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

**Prishtinë, 30 shtator 2021
Nr. ref.:AGJ1853/21**

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI82/21

Parashtrues

Komuna e Gjakovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, UPP-APP. nr. 1/2020, të 28 tetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Vjollca Shyti (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [UPP.APP-1/2020] e 28 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 12 prill 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, i cili, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 29 prill 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes postës kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese.
8. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 24 maj 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës së Gjykatës, si dhe autorizimin specifik për përfaqësim në Gjykatë.
10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të

Rregullores së Punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu Krasniqi si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu. Gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi u caktua kryesuese e Kolegjit shqyrtues.
12. Më 1 qershor 2021, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, dorëzoi kërkesë për dhënie të informatave lidhur me kërkesën KI82/21.
13. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KI82/21, caktoi gjyqtarin Radomir Laban si gjyqtar raportues në vend të gjyqtarës Gresa Caka-Nimani.
14. Më 11 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës përmes emailit dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar si dhe autorizimin specifik për përfaqësim në Gjykatë.
15. Më 24 qershor 2021, Gjykata e njoftoi palën e interesuar, Afrim Radoniqi, për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtit i ofroi një kopje të kërkesës.
16. Më 24 qershor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi informata se: *(1) a e keni njoftuar Parashtruesin e kërkesës, në këtë rast Komunën e Gjakovës, lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës? Cili është detyrimi ligjor për një lajmërim të tillë?; dhe (2) Parashtruesi i kërkesës – Komuna e Gjakovës, pretendon se Gjykata Supreme ka lejuar përdorimin e një mjeti juridik të palejuar, pasi që përsëritja e Procedurës nuk përcaktohet në Ligjin për Konfliktet Administrative, por vetëm. Cili është qëndrimi i Gjykatës Supreme lidhur me këtë pretendim të Komunës së Gjakovës?*
17. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 1 korrik 2021, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, dorëzoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me rastin KI82/21.
19. Më 2 korrik 2021, Gjykata Supreme ktheu përgjigje në kërkesën e Gjykatës për informata shtesë.
20. Më 7 korrik 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të njoftojë Gjykatën lidhur me datën kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
21. Më 9 korrik 2021, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesën që tregon se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 12 prill 2021.

22. Më 9 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

23. Fillimisht, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ishte palë në Gjykatë edhe në rastin KI32/17, në të cilin objekt shqyrtimi ishte Aktgjykimi [Pml.nr.276/2016] i 5 dhjetorit 2016 i Gjykatës Supreme. Në këtë rast Gjykata përmes Aktvendimit për papranushmëri kishte vendosur që kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
24. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ishte i punësuar në Komunën e Gjakovës në pozitën Avokat Publik Komunal, duke filluar nga viti 2008. Gjatë kohës përderisa pala e interesuar ishte duke punuar, Komuna e Gjakovës kishte pranuar njoftime nga Prokuroria për fillimin e veprimeve hetimore ndaj tij për kryerje të veprave penale gjatë ushtrimit të funksionit të tij, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK-së), veprës keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprës penale konflikt i interesit nga neni 424 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të KPRK-së. Rrjedhimisht, më 25 mars 2014, Kryetarja e Komunës përmes Vendimit [01 Nr. 118-2664] vendosi që të pezullojë Afrim Radoniqin me pagesë 50% të rrogës së tij, deri në marrjen e një vendimi nga Gjykata, dhe se punëdhënësi pas përfundimit të procedurës gjyqësore do të veprojë sipas ligjit për shërbimin civil të Kosovës. Ndaj Vendimit të Komunës së Gjakovës, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK).
25. Më 22 tetor 2014, KPMSHCK përmes Vendimit [Nr. A.02/354/2014] refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së interesuar Afrim Radoniqi, duke e lënë në fuqi Vendimin e lartcekur për pezullim parandalues të Komunës së Gjakovës.
26. Më 18 nëntor 2014, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, përmes padisë kishte kërkuar nga Gjykata Themelore që të anulohet Vendimi [Nr. A. 02/354/2014] i të paditurës KPMSHCK, i 22 tetorit 2014, me të cilin i ishte refuzuar ankesa kundër vendimit [nr. 118-2624/2014] të Kryetares së Komunës së Gjakovës të 25 marsit 2014 për pezullim parandalues. Ai pretendonte që Vendimi i KPMSHCK ishte i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrativë dhe Rregullores për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave.
27. Më 15 korrik 2016, KPMSHCK, në cilësinë e të paditurës dorëzoi përgjigje në padi duke kundërshtuar padinë e lartcekur nën pretendimin se e njëjta nuk rezulton nga faktet dhe provat e prezantuara dhe se me asnjë provë paditësi nuk ka mundur të argumentojë pretendimet e tij, duke propozuar që ta refuzojë padinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa të vërtetojë vendimin e saj.
28. Më 13 shtator 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [A.nr.2306/14] vendosi që të: (i) Aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e palës së interesuar Afrim Radoniqi; dhe (ii) Anulohet vendimi [A/02/354/2014] i 22

tetorit 2014, i të paditurës-KPMSHCK dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

29. Në një datë të paspecifikuar, KPMSHCK parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore në procedurë; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të ligjit material me propozimin që të shfuqizohet Aktgjykimi i lartcekur dhe të mbetet në fuqi vendimi [A/02/354/2014] i 22 tetorit 2014 i KPMSHCK-së. Përgjigje në ankesë parashtroi pala e interesuar, Afrim Radoniqi, me propozimin që ankesa e KPMSHCK të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i lartcekur të vërtetohet.
30. Më 21 mars 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr. 20/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e të paditurit KPMSHCK, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore vërtetohet.
31. Më 15 maj 2017, në procedurën për rishqyrtim dhe rivendosje, KPMSHCK përmes Vendimit [A/02/436/2016] vendosi: (i) të refuzojë si të pabazuar ankesën e 22 gushtit 2014, të dorëzuar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi; dhe (ii) e la në fuqi Vendimin mbi pezullimin [01 Nr. 118-2664] e 25 marsit 2014, të Komunës së Gjakovës.

Procedura e propozimit për Përmbarim të Aktgjykimit [AA.nr.20/2017] të 21 marsit 2017, të Gjykatës së Apelit

32. Më 2 nëntor 2017, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, parashtroi propozim për përmbarim kundër parashtruesit të kërkesës, Komunës së Gjakovës, për përmbarimin e dokumentit përmbarimor, Aktgjykimin [A.nr.2306/14] e 13 shtatorit 2016 të vërtetuar me Aktgjykimin [AA.nr.20/2017] e 21 marsit 2017, të Gjykatës së Apelit.
33. Më 8 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës, Komuna e Gjakovës, dorëzoi prapësimin kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit duke theksuar se: (i) Gjykata Themelore nuk ka kompetencë lëndore që të lejojë përmbarimin e propozuar; (ii) ekzekutimin e vendimeve administrative e bën organi kompetent i Administratës. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës theksonte se propozimi për përmbarim është i parakohshëm dhe pa objekt të përmbarimit, sepse përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk ia njeh të drejtën e kreditorit Afrim Radoniqi, por ishte vendosur që çështja t'i kthehet KPMSHCK-së për rishqyrtim dhe rivendosje. Përgjigje në prapësim nuk parashtroi pala e interesuar, Afrim Radoniqi.
34. Më 26 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Gjakovë përmes Aktvendimit [CP.nr.279/17] aprovoi si të bazuar: (i) prapësimin e debitorit, Komunës së Gjakovës, e 8 dhjetorit 2017; dhe (ii) anuloi Aktvendimin për përmbarim të Gjykatës Themelore [CP.nr.279/17] të 2 nëntorit 2017, dhe i prishi të gjitha veprimet përmbarimore të marra nga e njëjta.

Procedura penale ndaj Afrim Radoniqi dhe largimi nga puna

35. Më 18 korrik 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.105/15] palën e interesuar, Afrim Radoniqi: (i) e liroi nga akuza për veprën penale falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1 i Kodit Penal; (ii) e liroi nga akuza për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së; (iii) e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale konflikti i interesit nga neni 424 paragrafët 1 dhe 4 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 3000 EUR e të cilin dënim i akuzuari ishte i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.
36. Më 9 gusht 2016, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, parashtroi ankesë kundër pikës III të Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të: (i) shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) shkeljes së Ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që të aprovojë ankesën e tij si të bazuar; si dhe (iv) të ndryshojë pikën III të Aktgjykimin të lartcekur, apo të marrë vendim që çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.
37. Më 20 shtator 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.497/16] vendosi që: (i) me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së palës së interesuar, Afrim Radoniqi, ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë [PKR.nr. 105/15] i 18 korrikut 2016, vetëm përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal ashtu që të akuzuarit për vepër penale Konflikti i interesit nga neni 424 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 4 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dy mijë) Euro, e të cilën gjobë është i obliguar që ta paguajë në afat prej (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi; (ii) në pjesën liruese aktgjykimi mbetet i paprekur.

Procedura e largimit nga puna të palës së interesuar, Afrim Radoniqi

38. Komuna e Gjakovës, në bazë të Aktgjykimit [PAKR.nr.497/16] të Gjykatës së Apelit, inicioi procedurë disiplinore ndaj Afrim Radoniqit. Pra, më 7 mars 2017, Komisioni Disiplinor në Komunën e Gjakovës përmes Vendimit [01/070-01/2927] vendosi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përderisa pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale konflikti i interesit.
39. Më 30 mars 2017, pala e interesuar kishte dorëzuar ankesë kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës.
40. Më 5 maj 2017, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjakovës, përmes Vendimit [01-070-7914] konstatoi që Vendimi [01/070-01/2927] i Komisionit Disiplinor, i 7 marsit 2017 është në pajtim me paragrafin 4 të nenit 63 (përgjegjësitë) të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se “Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve

dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil”.

41. Në një datë të paspecifikuar, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK ndaj Vendimit të lartcekur të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjakovës, me kërkesën që të kthehet në punë.
42. Më 18 korrik 2017, KPMSHCK përmes Vendimit [A/02/250/2017] e refuzoi ankesën e palës së interesuar dhe vërtetoi vendimet e Komisionit Disiplinor dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjakovës.
43. Më 17 gusht 2017, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë me kërkesën e anulimit të vendimeve të të paditurit KPMSHCK, përkatësisht: (i) Vendimit [A/02/436/2016] të 15 majit 2017 (të përmendur në paragrafin 30, me të cilin ishte vërtetuar Vendimi i Kryetares së Komunës për pezullim); dhe (ii) Vendimit [A/02/250/2017] të 18 korrikut 2017 (me të cilin ishte lënë në fuqi Vendimi [01-070-7914] i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave).
44. Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) fillimisht bëri bashkimin e dy lëndëve, pasi që objekti i kërkesëpadisë dhe palët ishin të njëjta, dhe më 9 gusht 2018, përmes Aktgjykimit [A.nr. 975/2017] vendosi që të: (i) Aprovohet pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e palës së interesuar, Afrim Radoniqi; (ii) Anulohet Vendimi [A02/250/2017] i 18 korrikut 2017, i të paditurit KPMSHCK-së dhe vendimet e Komunës së Gjakovës, Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave [nr.01-070-7914], të 5 majit 2017 dhe Vendimi i Komisionit Disiplinor [01-070-01-2927] i 7 marsit 2017 dhe detyrohet Komuna e Gjakovës që paditësin, Afrim Radoniqi, të kthejë në vendin e punës, Avokat Publik Komunal me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës sipas Akt emërimit [01-118-143-9] të 1 qershorit 2013 nga momenti i largimit nga marrëdhënia e punës sipas vendimit të Komunës së Gjakovës të 7 marsit 2017; (iii) Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilin ka kërkuar anulimin e Vendimit [A02/436/2017] të 15 majit 2017 të paditurit, KPMSHCK-së dhe Vendimit të Komunës së Gjakovës [118-2624/2014], të 25 marsit 2014, si e pa bazuar.
45. Më 14 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës, Komuna e Gjakovës, dorëzoi ankesë kundër pjesës aprovuese, përkatësisht pikës I dhe II të dispozitivit të Aktgjykimit të lartcekur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë si të bazuar ankesën e parashtruar nga ai dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.
46. Më 17 shtator 2018, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, dorëzoi ankesë kundër pikës III të Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të cenimit të dispozitave të procedurës gjyqësore; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet pika III e

Aktgjykimit [A.nr. 975/18] të Gjykatës Themelore, të obligohet Komuna e Gjakovës që paditësit Afrim Radoniqi t'ia kompensojë të ardhurat personale të papaguara në lartësi prej 50% duke llogaritur kamatën ligjore duke filluar nga 25 marsi 2014 e deri më 5 maj 2017 si dhe, kompensimin e të gjitha benefiteve të tjera nga marrëdhënia e punës.

47. Më 21 shtator 2018, KPMSHCK dorëzoi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative; vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i ankimuar të anulohet si i pabazuar në ligj.
48. Më 26 shtator 2018, Komuna e Gjakovës dorëzoi përgjigje në ankesë, duke theksuar se Gjykata Themelore me rastin e vendosjes në pikën III të Aktgjykimit të saj, ka dhënë arsye të mjaftueshme, të qarta dhe të bazuara në dispozitat ligjore dhe se drejtë ka aplikuar të drejtën materiale.
49. Më 5 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr.505/2018]: (i) refuzon si të pabazuar ankesën e palës së interesuar, Afrim Radoniqi, të 17 shtatorit 2018, ndërsa vërteton pikën III të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; (ii) aprovon si të bazuara ankesat e të paditurit KPMSHCK-së dhe të parashtruesit të kërkesës, Komunës së Gjakovës, ndërsa pika II e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore prishet dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje; dhe (iii) Në pjesën tjetër, dispozitivi i Aktgjykimit të ankimuar mbetet i pandryshueshëm.
50. Më 29 nëntor 2019, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të Aktvendimit [AA.nr.505/2018] të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar.
51. Më 16 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës, Komuna e Gjakovës, përmes përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, i kontestoi në tërësi pretendimet e palës së interesuar, Afrim Radoniqi, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.
52. Më 20 janar 2020, Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) përmes Aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.15/2020] e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e palës së interesuar, Afrim Radoniqi, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [AA.nr. 505/2018] të 9 gushtit 2018. Në arsyetimin e saj Gjykata Supreme thekson se: *"[...] me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit [AA.nr.505/2019] të 5 nëntorit 2019, në pikën II të Aktvendimit, është anuluar Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë [A.nr.975/2017] të 9 gushtit 2018 dhe çështja i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Meqenëse, vendimi gjyqësor nuk është bërë i plotfuqishëm, pasi që lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, kjo Gjykatë e ka hedhur kërkesën si të palejueshme"*.

53. Pala e interesuar, Afrim Radoniqi, parashtroi kërkesë për përsëritje të procedurës me të cilën konteston ligjshmërinë e Aktvendimit [ARJ-UZVP nr.15/2020] të 20 janarit 2020, të Gjykatës Supreme. Pala e interesuar pretendon që me Aktvendimin e kontestuar, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendit gjyqësor, me të cilin pala e interesuar, Afrim Radoniqi, e kishte kontestuar vendimin e shkallës së dytë në pjesën ku është vërtetuar vendimi i shkallës së parë, me të cilin është refuzuar ankesa e palës së interesuar për tu anuluar Aktvendimi [A/02/436/2017] i 15 majit 2007 i KPMSHCK-së, e vendosur në pjesën me të cilën është anuluar vendimi i shkallës së parë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe nuk është vendosur në pjesën ku është refuzuar ankesa e paditësit.
54. Më 28 tetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [UPP-APP.nr.1/2020] lejoi si të bazuar propozimin për përsëritje të procedurës të paditësit Afrim Radoniqi, parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP.nr.15/2020] të 20 janarit 2020, kështu që anulohet Aktvendimi i cekur.
55. Më 14 maj 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A.nr.2691/2019] aprovon si të bazuar propozimin e Komunës së Gjakovës, të dhënë në parashtrësën e 11 majit 2021, dhe ndërpritet procedura sipas padisë së Afrim Radoniqit, deri sa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të vendosë lidhur me ankesën e Komunës së Gjakovës të 28 prillit 2021, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [UPP-APP.nr. 1.2020] të 28 tetorit 2020.

Komentet e palës se interesuar Afrim Radoniqi

56. Më 24 qershor 2021, pala e interesuar, Afrim Radoniqi, përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë thekson që *“ankesa e parashtruesit të kërkesës-Komunës së Gjakovës në Gjykatën Kushtetuese është keqpërdorim i të drejtave procedurale dhe, ka të vetmin qëllim që sa më gjatë të prolongohet vendosja meritore e kontestit të punës i cili kontest është filluar që nga viti 2014 dhe se për të njëjtin objekt të kërkesëpadisë deri më tani janë nxjerrë gjithsej 5 (pesë) Aktgjykime/ Aktvendime nga gjykata e shkallës së parë, të dytë dhe të tretë që rezulton me shkelje të dispozitave të Kushtetutës, përkatësisht të Neni 34 (E drejta për të mos u gjykuar dy (2) herë për të njëjtën çështje)”*.

Përgjigja e Gjykatës Supreme të Kosovës

57. Më 2 korrik 2021, Gjykata pranoi nga Gjykata Supreme përgjigjet në pyetjet e parashtruara: (1) *a e keni njoftuar Parashtruesin e kërkesës, në këtë rast Komunën e Gjakovës, lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës? Cili është detyrimi ligjor për një lajmërim të tillë?; dhe (2) Parashtruesi i kërkesës – Komuna e Gjakovës, pretendon se Gjykata Supreme ka lejuar përdorimin e një mjeti juridik të palejuar, pasi që përsëritja e Procedurës nuk përcaktohet në Ligjin për Konfliktet Administrative, por vetëm. Cili është qëndrimi i Gjykatës Supreme lidhur me këtë pretendim të Komunës së Gjakovës?*
58. Gjykata Supreme, lidhur me përgjigjen në pyetjen e parë (1), theksoi që: *“sa i përket informatave të kërkuara konstatuam se paditësi iu ka drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për rishikimin e aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.15/2020] me*

20.10.2020, për shkaqe sipas paditësit se Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar ka proceduar dhe ka rishqyrtuar pikën II të dispozitivit të aktvendimit AA. UZH.nr.505/2018 dt.05.11.2019, të Gjykatës së Apelit.

Në shkresat e lëndës Komuna e Gjakovës nuk ka qenë palë në procedurë dhe nuk ka evidence se të njëjtës iu ka dërguar kjo kërkesë.”

59. Gjykata Supreme lidhur me përgjigjen në pyetjen e dytë (2) theksoi që: “Sa i përket informatave për pikën 2) të kërkesës tuaj, si administratë e gjykatës nuk mund të komentojmë vendimin gjyqësor të kolegjit të kësaj gjykate dhe të japim ndonjë përgjigje profesionale sa i përket pretendimeve të Komunës së Gjakovës, se a lejohet përdorimi i këtij mjeti juridik, kjo është çështje e vlerësimit profesional dhe kompetencë e kolegjit të gjyqtarëve. Qëndrimi i kësaj gjykate është sipas aktgjykimit të kontestuar deri sa të vërtetohet e kundërta”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

60. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [UPP-APP.nr. 1/2020] i 28 tetorit 2020 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar janë cenuar: (i) parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë; dhe (ii) parimi i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

(i) Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procedurë

61. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se përderisa pala e interesuar, Afrim Radoniqi, ka paraqitur kërkesë për përsëritjen e procedurës, e njëjta do të duhej t'i dërgohej parashtruesit të kërkesës, përkatësisht Komunës së Gjakovës, pasi që të njëjtit kishin statusin e “palës së interesuar” në tërë procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, parashtruesit të kërkesës, Komunës së Gjakovës, i është pamundësuar dhe mohuar paraqitja e përgjigjes në atë kërkesë dhe i është pamundësuar paraqitja e kundër-provave.
62. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se si rezultat i mosnjohimit të Komunës së Gjakovës me propozimin e paditësit për përsëritjen e procedurës është shkelur parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural. Parashtruesi i kërkesës thekson se sipas GjEDNj-së, neni 6.1. i Konventës i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtrësive dhe argumenteve si dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e gjykatës (shih, ngjashëm GjEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993; *Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988).
63. Parashtruesi i kërkesës thekson se në një situatë të tillë analogjike, Gjykata Kushtetuese kishte vendosur me Aktgjykim në rastin nr. KI193/19, me

parashtrues *Salih Mekaj*. Sipas parashtruesit të kërkesës, në përmbledhjen e këtij Aktgjykimi, Gjykata kishte theksuar se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural, si elemente qenësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kërkojnë që gjykatat të vendosin një ekuilibër të drejtë në mes të palëve në procedurë, si dhe t'iu mundësohet atyre që të kenë një ballafaqim përmbajtësor të pretendimeve dhe argumenteve.

64. Pra, parashtruesi i kërkesës në vijim thekson që analogjia në mes të rasteve lidhur me shkeljet në procedurë që i kanë paraprirë Aktgjykimit të kontestuar dhe të rastit KI193/19, me parashtrues *Salih Mekaj* është prezente. Neni 6 i KEDNj-së [E drejta për një proces të rregullt] në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile thekson se "çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme".

(ii) Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor

65. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se Vendimi i kontestuar është arbitrar, që shkel parimin e sigurisë juridike, pasi që i njëjti në arsyetimin e vendimit të kontestuar nuk është përmendur asnjë arsyetim lidhur me lejimin e përsëritjes së procedurës. Veprimi i tillë, përkatësisht heshtja, mangësia totale e arsyetimit të lejueshmërisë së kërkesës për përsëritje të procedurës nga Gjykata Supreme, është veprim kundër kushtetues.
66. Në vijim, parashtruesi thekson se Gjykata Kushtetuese në një vendim të saj ka gjetur se funksioni i një vendimi të arsyetuar, sipas GjEDNj-së, është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për të apeluar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, 27 shtator 2001, paragrafi 30; *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; rastin e Gjykatës K197116, parashtrues *"IKK Classic"*, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 46; dhe KI22/16, *N. Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017, paragrafi 40). Për shkak të mos njoftimit të Komunës së Gjakovës me propozimin e paditësit për përsëritjen e procedurës është shkelur parimi i barazisë së armeve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural. Sipas GjEDNj-së, neni 6.1. i Konventës i detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të duhur të parashtresave dhe argumenteve si dhe provave të paraqitura nga palët në procedurë, pa paragjykuar se cili do të jetë ndikimi i tyre për vendimin e gjykatës (shih, ngjashëm GjEDNj, rastin *Kraska kundër Zvicrës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1993; *Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988). Sipas parashtruesit të kërkesës, ky lëshim i Gjykatës Supreme është bazë e mjaftueshme që Gjykata Kushtetuese të aprovojë këtë ankesë kushtetuese.
67. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson që Aktgjykimi i kontestuar në dispozitivin e tij thekson: "*Lejohet si i bazuar propozimi për përsëritje të procedurës së paditësit, ...*", ndërsa sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, nuk parashihet institucioni juridik i përsëritjes së procedurës. Aplikimi i këtij

institucioni inekzistent në procedurën e konfliktit administrativ, nuk është i përcaktuar, pasi që në Ligjin nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, në nenin 55, parashihet rishikimi (jo përsëritja e procedurës).

68. Përveç kësaj, parashtuesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme në këtë procedurë, meqë nuk kishte bazë juridike e as faktike për të rishikuar procedurën apo për të përsëritur procedurën, nuk ka dhënë asnjë bazë juridike për rishikim nga neni 55 i LKA-së. Mangësia absolute e arsyeve se pse është lejuar *"propozimi për përsëritje të procedurës"* paraqet bazë të mjaftueshme faktike dhe juridike që Aktgjykimin e atakuar e bën të kundërligjshëm, krijon pasiguri juridike që paraqet shkelje të parimeve themelore kushtetuese.
69. Në vijim, parashtuesi i kërkesës thekson që edhe për rishikim të përcaktuar në nenin 55 të LKA-së, nuk ka bazë për lejueshmërinë e tij, pasi që Gjykata Supreme do të duhej të shqyrtonte kushtet e lejueshmërisë dhe efektshmërisë të përcaktuara me nenin 55.2 dhe nenet 56 dhe 57 të LKA-së. Ndërsa, Gjykata Supreme është mjaftuar me dhënien e një arsytimi të përgjithshëm: *"Meqë me këtë aktgjykim është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ UZVP. nr. 15/2020] i 20 janarit 2020, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, si e palejuar, kjo gjykatë duke vlerësuar arsyet e paditësit të dhëna në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ka gjetur se të njëjtat janë të bazuara"*.
70. Në të njëjtën linjë argumentimi, parashtuesi i kërkesës thekson që Gjykata Kushtetuese duhet të vendos në këtë çështje se Gjykata Supreme e Kosovës e ka *"aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar"* dhe për pasojë ka pasur konkluzione arbitrare dhe qartazi të paarsyeshme ndaj tij dhe se ky qëndrim arbitrar i Gjykatës Supreme krijon precedent të keq, të dëmshëm për sistemin ligjor në Republikën e Kosovës.
71. Përfundimisht, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (I) të deklarojë ankesën kushtetuese të pranueshme; (II) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përkatësisht shkeljes së parimit të gjykimit të drejtë nga neni 6 i KEDNj-së; nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, parimit të sigurisë juridike, mangësisë së arsytimit të domosdoshëm të vendimit gjyqësor, shkeljes së parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit dhe i mos arsytimit të vendimit gjyqësor; (III) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [UPP-APP.nr. 1/2020] të 28 tetorit 2020; (IV) të kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [UPP-APP.nr. 1/2020] për rivendosje në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese; (V) të urdhërojë Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese, sa më shpejtë që është e mundur dhe lidhur për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
 - 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
 - 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- [...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.*
- [...]

Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative

Neni 21

Pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t'i sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Neni 30

1. Në padi duhen të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia, emri, mbiemri dhe vendbanimi, respektivisht selia e paditësit dhe e të paditurit, akti administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ. Bashkë me padinë duhet të bashkangjitet akti që kontestohet në origjinal ose kopje.

2. Nëse me padi kërkohet kthimi i sendit ose kompensimi i dëmit, duhet të shtrohet edhe kërkesa e caktuar në pikëpamje të sendit apo të shumës së dëmit të pësuar.

3. Bashkë me padi, paraqitet edhe nga një kopje e padisë dhe e dokumenteve të bashkëngjitura për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar, nëse ekzistojnë të tillë.

Neni 55 Rishikimi

1. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:

1.1. pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shtruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore;

1.2. vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuesit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbën vepër penale;

1.3. vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerr në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë;

1.4. dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rreme, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë;

1.5. pala konstaton apo krijon mundësi ta përdorë vendimin e mëparshëm të nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ; dhe

1.6. personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ.

2. Për shkak të rrethanave nga nën-paragrafi 1.1 dhe nën-paragrafi 1.5 i këtij paragrafi rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vet, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana t'i shtrojë në procedurën e mëparshme.

Neni 60

1. Mbi kërkesë për rishikim gjykata vendos në seancë të mbyllur.
2. Gjykata do ta hedhë poshtë kërkesën me vendim nëse vërteton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar ose kërkesa nuk është bërë në kohën e duhur, apo pala nuk e ka bërë të paktën të besueshme ekzistimin e bazës ligjore për rishikim.
3. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën sipas paragrafit 2. të këtij neni, do t'i dërgojë palës së kundërt dhe personave të interesuar dhe do t'i ftojë që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh t'i përgjigjen kërkesës.

Neni 61

1. Pas skadimit të afatit për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendos me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim.
2. Nëse lejohet rishikimi, do të shfuqizohet vendimi i mëparshëm tërësisht ose pjesërisht.
3. Veprimet e mëparshme procedurale, të cilat nuk ndikojnë në shkaqet e rishikimit, nuk përsëriten.
4. Me aktgjykim, me të cilin lejohet rishikimi, do të vendoset edhe për çështjen kryesore.

Neni 63

Dispozita të tjera të procedurës

Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.

Neni 53

[pa titull]

Gjykata vendos mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm ose kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, si rregull, në seancë të mbyllur, ndërsa vendimin e kundërshtuar e shqyrton vetëm brenda kufijve të kërkesës.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 160 [pa titull]

160.1 Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.

160.2 Pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë, tregimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.

160.3 Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.

160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohej edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.

160.6 Në pjesën arsyetuese të aktgjykimit kontumacional, aktgjykimit në bazë të pohimit, aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, apo të aktgjykimit për shkak të mungesës, jepen vetëm arsye që e justifikojnë dhënien e aktgjykimeve të këtilla.

Neni 182

[...]

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsye të aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie

midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

72. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
73. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

[...]

4. *Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

74. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

75. Fillimisht, Gjykata sqaron se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës, KI10/20, me parashtrues *"Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" SH. A. – Njësia Malësia e Re Prizren*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 tetorit 2020, paragrafi 35; rasti KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
76. Në vijim sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme procedurale, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [UPP-APP.nr.1/2020] e 28 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
77. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, gjithashtu rastin e GjEDNj-së: *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykim, i 9 korrikut 2012, paragrafi 144, si dhe shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës KI27/20, parashtrues *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim, i 22 korrikut 2020, paragrafi 43).
78. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të deklarohet e papranueshme në bazë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Meritat e kërkesës

79. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [UPP-APP.nr. 1/2020] i 28 tetorit 2020 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar janë cenuar: (i) parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë; dhe (ii) parimi

i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së këtyre pretendimeve, Gjykata gjithashtu do të zbatojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

80. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përkatësisht parashtruesi specifikon se në rastin e tij janë cenuar: I. Parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë, si rezultat i mosnjohimit të tij për kërkesën për përsëritje të procedurës të ushtruar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi; dhe II. Parimi i sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, lidhur me arsyetimin për lejimin për propozimin e për përsëritje të procedurës të paditësit.

I. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në procedurë

81. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit në mënyrë specifike e ndërlidhë me mosdërgimin e propozimit për përsëritje të procedurës të parashtruar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi, si dhe mos dhënies së mundësisë për të paraqitur përgjigje në këtë kërkesë.
82. Rrjedhimisht, në dritën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve.
83. Në fund, Gjykata gjatë shqyrtimit dhe elaborimit të parimeve të përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GjEDNj-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve do të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse rastet e GjEDNj-së dhe të Gjykatës, të përmendura nga parashtruesi në kërkesën e tij i referohen rrethanave të ngjashme faktike dhe juridike si ato në rastin e tij dhe po ashtu do të vlerësojë nëse këto raste janë të aplikueshme në rastin e tij.
- a. Parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GjEDNj-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve***
84. Koncepti i një gjykimi të drejtë përfshin të drejtën themelore të pasurit gjykim bazuar në parimin e kontradiktoritetit. Njëkohësisht, ky parim është i lidhur ngushtë me parimin e barazisë së armëve (shih rastin e GjEDNj-së: *Regner kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146).

85. Gjykata duke iu referuar edhe praktikës së GjEDNJ-së, fillimisht rithekson se parimi i “*barazisë së armëve*” është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë (shih rastin e GjEDNJ-së, *Borgers kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 12005/86, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 24).
86. GjEDNJ dhe Gjykata në praktikën gjyqësore ka theksuar se parimi i “*barazisë së armëve*”, kërkon “*ekuilibër të drejtë midis palëve*” ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare (shih rastet e GjEDNJ-së *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, kërkesa nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33 shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140, *Grozdanoski kundër ish-RJM*, kërkesa nr. 2150/03, Aktgjykim i 31 majit 2007, shih po ashtu rastet e Gjykatës: KI230/19, me parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 8 janarit 2021, paragrafi 98; KI239/19, me parashtrues *Hakif Veliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 marsit 2021, paragrafi 112; KI52/12, parashtruese *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40).
87. Gjykata më tej rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kërkesa e barazisë së armëve, në kuptim të një ekuilibri të drejtë midis palëve, vlen në parim si për raste civile ashtu edhe për ato penale (shih rastin e GjEDNJ-së: *Dombo Beher B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33). Gjithashtu, kërkesat që rezultojnë nga e drejta për procedura kundërshtuese janë në parim të njëjtat si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale (shih rastin e GjEDNJ-së: *Werner kundër Austrisë*, Aktgjykim i 24 nëntorit 1997, paragrafi 66).
88. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se gjykimi i drejtë gjithashtu përfshin të drejtën për gjykimin në pajtim me “*parimin e kontradiktoritetit*”, parim i cili është i ndërlidhur me parimin e “*barazisë së armëve*”. Në këtë kontekst, në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm, veçanërisht në lidhje me rëndësinë që i kushtohet paraqitjeve dhe rritjes së vëmendjes apo ndjeshmërisë së publikut ndaj administrimit të drejtë të drejtësisë (shih rastin *Borgers kundër Belgjikës* të cituar më lartë, paragrafi 24).
89. E drejta për procedurë kontradiktore nënkupton në parim mundësinë që palët në një gjykim penal ose civil të kenë njohuri dhe të komentojnë mbi të gjitha provat e marra ose parashtruesat e dorëzuara, madje edhe nga një anëtar i pavarur i shërbimit juridik kombëtar, me qëllim që të ndikojnë në vendimin e gjykatës (shih rastet e GjEDNJ-së: *Ruiz-Mateos kundër Spanjës*, Aktgjykim i 23 qershorit 1993, paragrafi 63; *McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 24 shkurtit 1995, paragrafi 80; *Vermeulen kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996, paragrafi 33; *Lobo Machado kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 20 shkurtit 1996, paragrafi 31; *Kress kundër Francës*, Aktgjykim i 7 korrikut 2001, paragrafi 74). Kjo kërkesë mund të zbatohet gjithashtu para një Gjykate Kushtetuese (shih rastin e GjEDNJ-së: *Milatová dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 21 qershorit 2005, paragrafët 63-66; *Gaspari kundër Sllovenisë*, Aktgjykim i 21 korrikut 2009, paragrafi 53).

90. Shembuj të mosrespektimit të parimit të barazisë së armëve, përkatësisht GjEDNj-ja kishte gjetur që ky parim ishte shkelur në rastet kur njëra nga palët ishte vendosur në një disavantazh të qartë: ankesa e një pale nuk iu dha palës tjetër, e cila për këtë arsye nuk kishte asnjë mundësi të përgjigjej (shih rastin e GjEDNj-së: *Beer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19).

b. Zbatimi i këtyre parimeve në rastin e parashtruesit të kërkesës

91. Gjykata, fillimisht rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës, Komunës së Gjakovës, për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit si rezultat i mosdërgimit të propozimit për përsëritje të procedurës të parashtruar nga pala e interesuar, Afrim Radoniqi, si dhe mos dhënies së mundësisë për të paraqitur përgjigje në këtë kërkesë.
92. Në lidhje me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se kishte kërkuar nga Gjykata Supreme informatën se a e kishte njoftuar e njëjta parashtruesin e kërkesës, Komunën e Gjakovës, lidhur me propozimin për përsëritje të procedurës? Si dhe cili ishte detyrimi ligjor për një lajmërim të tillë?
93. Gjykata Supreme në përgjigjen e ofruar Gjykatës të 2 korrikut 2021, theksoi si në vijim:

“Sa i përket informatave të kërkuara konstatuam se paditësi iu ka drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për rishikimin e aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.15/2020] me 20.10. 2020, për shkaqe sipas paditësit se Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar ka proceduar dhe ka rishqyrtuar pikën II të dispozitivit të aktvendimit [AA.UZH.nr.505/2018] dt.05.11.2019 të Gjykatës së Apelit.

Në shkresat e lëndës Komuna e Gjakovës nuk ka qenë palë në procedurë dhe nuk ka evidencë se të njëjtës iu ka dërguar kjo kërkesë.”

94. Në vijim Gjykata vë theksin tek (i) paragrafi 3 i nenit 60; dhe (ii) paragrafi 1 i nenit 61 të Ligjit për Konfliktet Administrative që përcaktojnë:

Neni 60

[...]

3. Nëse gjykata nuk e hedh poshtë kërkesën sipas paragrafit 2. të këtij neni, do t’ia dërgojë palës së kundërt dhe personave të interesuar dhe do t’i ftojë që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh t’i përgjigjen kërkesës.

[...]

Neni 61

1. Pas skadimit të afatit për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendos me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim.

95. Së pari, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në përgjigjen e dhënë me 2 korrik 2021, deklaroi se nuk ia ka dorëzuar kërkesën për përsëritje të procedurës Komunës së Gjakovës. Gjithashtu, Gjykata Supreme deklaroi se Komuna e Gjakovës nuk ishte palë në procedurë. Përkundër përgjigjes së dhënë, Gjykata vëren se ekzistonte një detyrim për dërgimin e kërkesës për përsëritje të procedurës edhe palës së kundërt dhe personave të interesuar, që derivonte nga dispozitat e lartcekura të Ligjit për Konfliktet Administrative.
96. Gjykata rikujton se GjEDNj dhe Gjykata në praktikën e tyre gjyqësore kanë theksuar që parimi i “barazisë së armëve” kërkon “një baraspeshë të drejtë ndërmjet palëve”, ku secilës palë duhet dhënë mundësia e arsyeshme për të paraqitur rastin e vet në kushte që nuk e vënë atë në pozitë konsiderueshëm të pabarabartë *vis-à-vis* palës kundërshtare. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka dështuar të garantojë zbatimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimin e kontradiktoritetit procedural, sepse parashtruesi i kërkesës është vënë në një disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* paditësit, palës së interesuar, Afrim Radoniqi, duke u privuar nga mundësia për të pasur një ballafaqim real dhe përmbajtësor me argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga pala e interesuar, si palë kundërshtare në procedurë.
97. E drejta në procedurë kontradiktore në parim nënkupton mundësinë që palët në procedurë penale ose kontestimore të jenë në dijeni dhe të komentojnë për të gjitha provat e administruara ose për parashtruesat e paraqitura, madje edhe nga një anëtar i pavarur i shërbimit juridik nacional, ashtu që të kenë ndikim në vendimin gjyqësor. Pra, Gjykata konsideron se detyrimi i njoftimit të palës kundërshtare, nga gjykatat, për ushtrimin e mjeteve juridike kundër tyre, nuk është qëllim në vetvete. Ky detyrim është hap i domosdoshëm procedural për t’ua mundësuar palëve që të trajtohen në mënyrë të barabartë, të kenë mundësi të kundërshtojnë pretendimet dhe argumentet e palës kundërshtare dhe të paraqesin rastin e tyre në mënyrë efektive (shih rastin e Gjykatës KI193/19, me parashtrues *Salih Mekaj*, Aktgjykim i 31 dhjetorit 2020, paragrafi 59).
98. Prandaj, Gjykata konsideron se ky mosdërgim i kërkesës së lartcekur dhe mungesa e ndonjë mundësie për parashtruesin e kërkesës, Komunën e Gjakovës, për t’u përgjigjur në kërkesën për përsëritje të procedurës të palës së interesuar, Afrim Radoniqi, përbën një shkelje të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve siç garantohet nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 i KEDNj-së (shih, *mutandi mutandis*, rastin e Gjykatës KI209/19, me parashtrues *Memli Krasniqi*, Aktgjykim i 26 nëntorit 2020, paragrafi 57).
99. Gjykata e përsërit se shembuj të mosrespektimit të parimit të barazisë së armëve, respektivisht GjEDNj ka konstatuar se ky parim është cenuar në rastet kur njëra nga palët është vënë në pozitë qartazi të pafavorshme: ankesa e njëres palë nuk i është dhënë palës tjetër, e cila kështu nuk ka pasur mundësinë të përgjigjet (shih, rastin ESLJP-a: *Beer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19).
100. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konsideron se ky lëshim i Gjykatës Supreme përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme, sepse

parashtruesi i kërkesës është privuar nga e drejta e tij për një proces të rregullt gjyqësor, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.

101. Prandaj, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNj-së.
102. Tutje, Gjykata qartëson se kur ajo shqyrton procedurën në tërësi, në ndërlidhje me nenin 31 të Kushtetutës, para së gjithash ajo vlerëson: 1) nëse parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideron relevante për rastin e tij; 2) nëse atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare dhe nëse të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; 3) nëse arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; 4) nëse në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih rastet e Gjykatës: KI193/19, me parashtrues *Salih Mekaj*, cituar më lartë, paragrafi 62; KI118/17, parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GjEDNj, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
103. Duke pasur parasysh që Gjykata ka gjetur shkelje të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në kuadër të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së, nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për sa i përket parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, lidhur me arsyetimin për lejimin për propozimin e për përsëritje të procedurës të paditësit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 shtator 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm, Aktgjykimin [UPP-APP.nr. 1/2020] e 28 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- IV. TË KTHEJË Aktgjykimin [UPP-APP.nr. 1/2020] e 28 tetorit 2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme të Kosovës që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 9 mars 2022, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VIII. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani